



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01-Nr.400-2428/15
Kaçanik, 30.01.2015

Në bazë të nenit 17 (h), (f) dhe (r) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 17 alinea 2 e Rregullores për caktimin e Kritereve për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve 01 Nr. 16-27192/12, si dhe nenit 40 pika 4 e Ligjit për Arsimin Parauniversitar Nr. 04/L-047, me propozimin e Kryetarit të Komunës 01Nr. 400-2424/15 prej datës 21.01.2015, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 30.01.2015, mori këtë:

V E N D I M
LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË
DREJTORISË SË ARSIMIT DHE KULTURËS

I.

Me këtë Vendim, Lejohen mjete financiare nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve në shumë, 108,989.00 € për realizimin e projekteve të drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës.

II.

Shuma e mjeteve të lejuara si në pikën I. të këtij Vendimi, sigurohen nga programi buxhetor i drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit--përkatësisht nga kategoria buxhetore e Subvencioneve dhe Transfereve, me destinim për realizimin e këtyre projekteve;

1. Pagesa e Transportit të nxënësve me nevoja speciale në relacionin Kaçanik- Prizren, për periudhën janar-dhjetor 2015,
2. Subvencionimin e kategorive të ndryshme të nxënësve me nevoja speciale,
3. Pagesa e Transportit të nxënësve të shkollave fillore të fshatrave, Sllatinë, Fushë e Pajtimit dhe Kërbliq, për periudhën; janar-dhjetor 2015,
4. Pagesa e Transportit të nxënësve të shkollave të mesme të komunës së Kaçanikut me raste sociale me 50% të çmimit të biletës,
5. Subvencionimi i Aktiviteteve Kulturore,
6. Subvencionimi i Klubeve Sportive, Shoqërive Kulturore Artistike, KVRL, OJQ-ve, Klubi Letërarë, Atelea Artistike dhe Aktivitete jashtë-mësimore me nxënës, për vitin 2015.

III.

Shpendarjen e mjeteve për realizimin e projekteve si në pikën II. të këtij Vendimi, do të bëhet sipas Planit të hartuar nga drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, me tekstin e mëtejshëm: "Projekt- Plani i shpenzimeve në kategorinë buxhetore, Subvencione dhe Transfereve, për aktivitete kulturore, sportive, arsimore dhe jashtë arsimore " viti 2015, i cili Plan është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen : Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

V.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi Komunal.

Me këtë Vendim njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria e Ekonomisë , Financave dhe Zhvillimit dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi



Republika e Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut



Komuna Kaçanik
Opstina Kacanik
Municipality of Kacanik

Drejtoria e Arsimit, kulturës, Rinisë dhe Sportit
04Nr.zyrtar Dt.20.01.2015

**PROJEKT- PLANI I SHPENZIMEVE NE KATEGORINË BUGJETORE SUBVENCIONE DHE TRANSFERE
PËR AKTIVITETE KULTURORE,SPORTIVE,ARSIMORE DHE JASHTË ARSIMORE**

VITI 2015

-I-

Nr.	Emertimi i projektit	Shuma
	Aktivitetet kulturore	
1	Pavarësia Kosovës	1,150.00
	Akademia Solemne	
	Pikat artistike	200.00
	Ekspozitë	200.00
	Turneu në Futboll	
	Shpërblimet	400.00
	Transporte	150.00
	Pagesa e fushës sportive	150.00
	Pije freskuese	50.00
2	5,6,7, 8 dhe 11 Marsi -epopeja e UÇK-së, Dita e Mësuesit, Dita e Gruas,	400.00
	Koktej per ditën e mësuesit	200.00
	Lule dhe Kurora	200.00
3	"Dita e Planetit"	300.00

	Ekspozitë,	-
	Koncert,	100.00
	Krosi pranveror	200.00
4	1 Qershori -Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve dhe e Viktimave të Pafajshme të Agresionit	200.00
	Koncert për fëmijë	200.00
5	11 Qershori-Dita e Çlirimit të Kaçanikut	8,800.00
	Akademi përkujtimore -	150.00
	Fetivali tradicional i SHKA-ve -	8,500.00
	Ekspozitë -	150.00
6	Koncert më moton” Mirë se vini mërgimtarë”	500.00
	Pagesa e SHKA „SHQIPONJA”	100.00
	Pagesa e SHKA „GRYKA E KAÇANIKUT”	100.00
	Rock grupet	300.00
7	10 Gushti -Dita e Dëshmorëve të Kaçanikut	1,075.00
	Ftesa	150.00
	Njoftime publike	50.00
	100 maica me mbishkrim për vrapim dhe defile	300.00
	Pika artistike për akademi përkujtimore	500.00
	Koktej	75.00
8	Dita e Rinisë	1,150.00
	Lojra pa kufi	200.00
	Shfaqje teatrale	200.00
	Kuiz diturie	50.00
	Vrapim,Turnir në futboll,basketboll,volejball e ping pong	300.00
	Koncert përmbyllës i aktiviteteve	400.00
9	Festat e Nëntorit	500.00
	Akademi -	300.00
	Koncerte, shfaqje,aktivitete sportive , defile -	200.00
10	Dita e Personave me Aftësi të Kufizuara – 3 Dhjetori	400.00
	Koncert	200.00
	Ekspozitë	100.00
	Koktej	100.00
11	Dita Botërore Kundër AIDS-it	50.00

	Ligjërime dhe debate –	50.00
12	Dita Ndërkombëtare kundër duhanit	200.00
	Aktivitete sportive,Turnir me moton „Sport jo Duhan”	200.00
13	Dita Ndërkombëtare e Rinisë	300.00
	Pije për garuesit	100.00
	Koncert me rock-grupet	200.00
14	Rrugëtimi I nxënësve te familjeve të Dëshmorëve për në Shtetin e Gjermanisë me karakter bashkëpunimi dhe Shkëmbimin e përvojave me nxënës	1,500.00
	TOTALI I AKTIVITETE KULTURORE	16,525.00

II		
Subvencionimi Klubeve Sportive,Shoqërit kulturo artistike,KVRL dhe Klubi Letrarë Atelea Artistike		
1	SHKA „Shqiponja-	2,000.00
2	SHKA „Gryka e Kaçanikut”	2,000.00
3	KVRL	2,000.00
4	Atelea Artistike	500.00
5	Letrarët e Rinjë	500.00
6	Handikosi	3,500.00
	TOTALI	10,500.00

III		
Subvencionimi I Klubeve Sportive:		
1	KF “Lepenci”	20,000.00
2	KB “ Lepenci “	2,000.00
3	KH “ Lepenci “ (meshkuj femra)	3,000.00
4	KB “ Kacaniku” (meshkuj femra)	3,000.00
5	KFF “ Kaçanikasja “	2,000.00
6	KT “ Shqiponja “	2,000.00
7	KSH” Lepenci “	1,200.00
8	Klubi Peshkatarve	500.00
9	Shoqata e Pedagogeve te K.Fizike	800.00
10	KP “ Kaçaniku “	800.00
	TOTALI	35,300.00

IV

Aktivitetet jashtë mësimore me nxënës:

	<u>Olimpiada Matematike e Kosovës</u>	318.00
	-Ushqim dhe pije per nxenes – 12x1.5€=18€	18.00
	-Transporti I nxenesve- 12x20€=240€	240.00
	-Pagesa e hartuesit te testeve dhe komisionit – 3x20€=60.00€	60.00
	<u>Gjuhetari I Ri 2014</u>	232.50
	-Ushqim dhe pije per nxenes – 35x1.5€=52.50€	52.50
	-Transporti I nxenesve 12x10€=120.00€	120.00
	-Pagesa e hartuesit te testeve dhe komisionit – 3x20€=60€	60.00
	<u>Garat Komunale te Diturisë (në 7 Lëndë)</u>	597.50
	-Ushqim dhe pije per nxenes – 145x1.5€=217.50€	217.50
	--Transporti I nxenesve- 12x20€=240.00€	240.00
	--Pagesa e hartuesit te testeve dhe komisionit – 7x20€=140.00€	140.00
	<u>Testi Arritshmerisë per kl.IX-ta dhe Testi Maturës 2014</u>	1,350.00
	Ushqim dhe pije per adiministruesit e testit – 450.00€	450.00
	Pije për nxënësit (UJE)	900.00
	Totali:	2,498.00

V

TRANSPORTI I NXËNËSVE TË KATEGORIVE TË NDRYSHME

1	Pagesa e Transportit të nxënësve me nevoja speciale Kaçanik-Prizeren Janar deri Dhjetor 2015	1,800.00
2	Subvencione për kategori të ndryshme për nxënës me nevoja speciale	2,000.00
3	Pagesa e Transportit të nxënësve të Shkollave Fillore të fshatrave Sllatinë,F.Pajtimit dhe Korbliq, Janar deri Dhjetor 2015	9,500.00
4	Pagesa e transportit të nxënësve të Shkollave të Mesme të Komunës së Kaçanik me raste sociale me 50% të biletës	30,866.00
	TOTALI	44,166.00
TOTALI 1+2+3+4+5		108,989.00